



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D I M

Nr. 7 , datë 30.6.2007

PËR

MIRATIMIN E UDHËZIMIT TË PËRBASHKËT PËR
MIRADMINISTRIMIN E REZERVAVE UJORE DHE
MOSSHFRYTËZIMIN PA LEJE TË UJIT DHE TË ZHAVORREVE

Në mbështetje të shkronjës “a”, të nenit 6, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, “Për rezervat ujore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e udhëzimit të përbashkët për miradministrimin e rezervave ujore dhe mosshfrytëzimin pa leje të ujit dhe të zhavorreve të ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, ministrit të Financave, ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, ministri i Financave, ministri i Brendshëm, ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe kryetarët e këshillave të baseneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

SALI BERISHA

Zëvendëskryetar
dhe
ministër i Mjedisit, Pyjeve
dhe Administrimit të Ujërave
L. Xhuveli
Lufter XHUVELI





REPUBLIKA E SHQIPERISE

**Ministria e Mjedisit, Pyjeve
dhe Administrimit te Ujerave**
Nr 3096 prot.date 5. 07. 2007

**Ministria e Puneve, Publike
Transportit dhe Telekomunikacionit**
Nr _____ prot.date _____

Ministria e Financave
Nr 534/prot.date 23.8.07
12

Ministria e Brendeshme
Nr 4159/prot.date 10.07.07
12

**Ministria e Bujqesise, Ushqimit
dhe Mbrojtjes se Konsumatorit**
Nr 2671 prot.date 10.7.2007

UDHEZIM I PERBASHKET

Ne zbatim te programit te Qeverise per te mbeshtetur zhvillimin e qendrueshem te bizneseve qe bazohen tek rezervat ujore,

Mbeshtetur ne konkluzionet e mbledhjes te Keshillit Kombetar te Ujit te dates 7.6.2007,

Bazuar ne shkronjen "a", pika 1, neni 6 i ligjit 8093 date 21.3.1996 "Per rezevat ujore",

Ne zbatim te nenit 102 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise,

UDHEZOJME:

1. Shfrytezimi i rezervave ujore te jete objekt i vazhdueshem kontrolli i Keshillave te Baseneve Ujembledhes dhe i strukturave ne juridiksionin e tyra.
2. Qendra Kombetare e Regjistrimit dhe organet tatimore te mos regjistrojne subjekte private qe nuk jane te paisura me leje shfrytezimi sipas formularit tip te miratuar nga KKKU si ne rastin e shfrytezimit te zhavoreve ashtu edhe ne rastin e perdorimit te ujit.
3. Ne varesi te Kryetarit te Basenit Ujembledhes te funksionojte nje task force me detyren per te kontrolluar dhe kerkuar zbatimin e ligjit ne menyre te bashkrenduar dhe organizuar, ne te gjithe territorin e basenit ujembledhes. Ne perberje te task forces te jene perfaqesues te :
 - Agjensive te basenit te Ujit
 - Agjensive Rajonale te Mjedisit,
 - Bordeve te Kullimit

- Policise ndertimore,
- Policise tatimore,
- Policise se shtetit.

Si dhe persona te tjere, perfaqesues institucionesh apo te Qeverisjes Vendore te autorizuar nga Kryetari i Keshillit te Basenit te Ujit.

4. Task forca dhe organet e ngarkuara me ligj te bejne bllokimin, gjobitjen apo sekuestrimin e autosondave qe shpojne pa leje, te eskavatoreve e automjeteve qe punojne ne zona te pa miratuara dhe pa leje si dhe te automjeteve qe transportojne zhavore pa dokument shoqerues, apo qe punojne ne lume pa targa.
5. Keshillat e Baseneve Ujembledhes, mbi bazen e raportimeve me shkrim, te analizojne çdo tre muaj situaten ne shfrytezimin e rezervave ujore, angazhimin e seiciles nga strukturat e permendura ne piken 3 per aktivitetin e tyer ne lidhje me rastet e shfrytezimit te zhavoreve dhe ujit pa leje dhe per gjendjen e masat e marra te njoftojne me shkrim zv/Kryetarin e KKU;
6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerve njofton me shkrim mbledhjet e KKU-s, per zbatimin e detyrave te ketij Udhezimi te Perbashket.

Lufter XHUVELI

**Minister i Mjedisit, Pyjeve
dhe Administrimit te Ujerve**

Ridvan BODE

Minister i Financave

Sokol OLLIASHI

**Minister i Punëve Publike
Transportit dhe Telekomunikacionit**

Bujar NISHANI

Minister i Brendshem

Jemin GJANA

**Minister i Bujqesise, Ushqimit
dhe Mbrojtjes se Konsumatorit.**